



VENDIM

Nr. 66 Datë 11.05.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIM E SHOQERISE
“GAMA ENERGY” SH.P.K., NE AKTIVITETIN E PRODHIMIT TE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HEC “LENA 1”, “LENA 2” DHE
“LENA 2A” ME FUQI TE INSTALUAR PËRKATËSISHT 1.95 MW; 2.3
MW DHE 0.25 MW (FUQI TOTALE 4.5 MW).**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 8, 9 dhe 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**GAMA ENERGY**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie nga Hec ”Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”.

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Formati i aplikimit është plotësuar ne mënyrë korrekte

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.1 Është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.2 Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3 Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik është plotësuar tërësisht

Neni 9, pika 4.1.5 Leje nga institucione te tjera. Është plotësuar pjesërisht.

Është ne proces miratimi i pikës se lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

Për dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshëm dhe Rinovimit te Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k., ne aktivitetin e prodhimit te energjisë elektrike nga Hec “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A” me fuqi te instaluar përkatësisht 1.95 MW; 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI